
MIT'HAT FRASHËRI, GJERGJ FISHTA DHE NDRE MJEDA:
ARKITEKTË TË KONGRESIT TË MANASTIRIT
MIT'HAT FRASHËRI, GJERGJ FISHTA AND NDRE MJEDA:
ARCHITECTS OF THE CONGRESS OF MANASTIR.

Prof. dr. SHEZAI RROKAJ

Universiteti i Tiranës

sezai.rrokaj@unitir.edu.al

Abstrakt

Pas Kuvendit të Lezhës dhe Lidhjes së Prizrenit, Kongresi i Manastirit është, pa dyshim, ngjarja kombëtare më madhore, ku janë marrë vendime të rëndësishme për të ardhmen e shqiptarëve. Por, ndryshe nga dy ngjarjet e para, Kongresi i Manastirit shpërfaq një spektër më të gjerë për nga problematika e larmishme kombëtare e këtyre vendimeve. Përpos vendimeve kulturore e gjuhësore, Kongresi do të merrte edhe vendime të tjera politike, administrative, plot 17 syresh, të cilat u vunë në funksion të njëra-tjetrës. Në këtë rast vlen të theksohet, gjithashtu, se për herë të parë deri në këtë kohë shqiptarët po e konceptonin ta realizonin historinë e tyre kombëtare të bashkimit dhe të shkëputjes nga pushtuesi i huaj përmes njësimi shpirtëror, siç ishte gjuha shqipe me alfabet të njësuar latin. Uniteti kulturor e gjuhësor nëpërmjet njësimi alfabetik, jo vetëm krijonte një kohezion shpirtëror kombëtar më natyror brenda gjuhës shqipe e folësve të saj, por gjithaq ky unifikim alfabetik po i shkëputte shqiptarët nga alfabetet e vendeve fqinje, të cilat haptazi apo tinëzisht ushqenin qëllime kombëtare asimiluese ndaj tyre.

Studiues të shumtë, si: historianë, gjuhëtarë, kritikë letrarë, didaktë e politologë i janë referuar dhe kanë analizuar nga këndvështrime të ndryshme këtë ngjarje, duke na dhënë studime komplekse, herë përmes trajtimeve të çështjeve që në mënyrë të ndërsjellë kanë pasur ndikim te njëra-tjetra, e herë duke u ndalur në mënyrë të posaçme vetëm te një çështje prej vendimeve të marra nga Kongresi. Kjo shpjegohet me faktin se Kongresi i Manastirit ishte produkt historik kombëtar gjithëpërfshirës. Ai u përball me një problematikë komplekse politike, shoqërore, kulturore e arsimore, e cila e bëri bashkë elitën më të rëndësishme kombëtare të kohës, me synimin për t'u dhënë zgjidhje këtyre çështjeve të themelore, duke e filluar punën me njësimin e alfabetit dhe duke e zgjeruar problematikën vendimmarrëse prej njësimi të alfabetit. Njësimi i alfabetit u bë në fakt shtrati kulturor për bashkues tek i cili konvergonin të gjitha çështjet që synonin bashkimin kombëtar Veri-Jug, myslimanë dhe të

krishterë me synim shkëputjen nga Perandoria Osmane dhe nga vendet përreth si dhe hedhjen e themeleve të shtetit shqiptar.

Ky kongres ia arriti të bënte bashkë në tryezë problemet që shqetësonin shqiptarët në atë kohë dhe intelektualët e veprimtarët patriotë, të cilët bënëin përpjekje të izoluara për zgjidhjen e çështjeve të veçanta. Nga ana tjetër, në këtë kongres u gjet edhe 'çelësi' nga duhej të fillonte zgjidhja e tyre, siç ishte më së pari përcaktimi i një alfabeti të njësuar përbashkues mes vetes dhe ndarjes kësisoj nga alfabetet e tjera, bashkë me vendet dashakeqe që i përdornin.

Fjalë kyçe: *Kongres, Manastir, alfabet, njësim, latin, shkronjë.*

Abstract

After the League of Lezhë and the League of Prizren, the Congress of Manastir is undoubtedly the most significant national event, where crucial decisions were made for the future of Albanians. However, unlike the first two events, the Congress of Manastir reveals a broader spectrum of issues related to the diverse national problems addressed by its decisions. In addition to cultural and linguistic resolutions, the Congress also adopted 17 other political and administrative decisions, all of which were interconnected and functioned in harmony. It is important to highlight that, for the first time, Albanians were conceptualizing the realization of their national history of unification and separation from foreign domination through spiritual unity, embodied in the Albanian language with a unified Latin alphabet. Cultural and linguistic unity through the standardization of the alphabet not only created a more natural national spiritual cohesion among Albanian speakers but also served to sever the Albanians from the alphabets of neighboring countries, which openly or covertly pursued assimilationist goals against them.

Many scholars, including historians, linguists, literary critics, educators, and political scientists, have examined and analyzed this event from various perspectives, producing complex studies. These studies often explore interrelated issues that influenced one another or focus specifically on a single aspect of the Congress's decisions. This reflects the fact that the Congress of Manastir was an inclusive national historical product. It tackled a complex array of political, social, cultural, and educational problems, bringing together the most prominent national elite of the time to address these fundamental issues, starting with the unification of the alphabet and expanding decision-making beyond alphabet standardization. The unification of the alphabet became the cultural bedrock where all efforts for national unity converged, aiming to bridge the North-South divide, unite Muslims and Christians, break away from the Ottoman Empire and neighboring countries, and lay the foundations of the Albanian state.

This Congress succeeded in addressing the concerns troubling Albanians at the time and brought together patriotic intellectuals and activists, who had been working in isolation on specific issues, to collectively seek solutions. Moreover, the Congress identified the 'key' to resolving these challenges, starting with the establishment of a unified and inclusive alphabet, which simultaneously marked a departure from other alphabets and the ill-intentioned countries that promoted them.

Keywords: *Congress, Manastir, alphabet, unification, Latin, letters.*

1. Hyrje

Pas Kuvendit të Lezhës (1444) dhe Lidhjes së Prizrenit (1878), Kongresi i Manastirit (1908) është, pa dyshim, ngjarja kombëtare më madhore, ku janë marrë vendime të rëndësishme për të ardhmen e shqiptarëve. Por, ndryshe nga dy ngjarjet e para, Kongresi i Manastirit shpërfaq një spektër më të gjerë për nga problematika e larmishme kombëtare e këtyre vendimeve. Përpos vendimeve kulturore e gjuhësore, Kongresi do të merrte edhe vendime të tjera politike, administrative, plot 17 syresh, të cilat u vunë në funksion të njëra-tjetrës. Në këtë rast vlen të theksohet gjithashtu se për herë të parë deri në këtë kohë shqiptarët po e konceptonin ta realizonin historinë e tyre kombëtare të bashkimit dhe të shkëputjes nga pushtuesi i huaj përmes njësimit shpirtëror, siç ishte gjuha shqipe me alfabet të njësuar latin. Uniteti kulturor e gjuhësor nëpërmjet njësimit alfabetik, jo vetëm krijonte një kohezion shpirtëror kombëtar më natyror brenda gjuhës shqipe e folësve të saj, por gjithaq ky unifikim alfabetik po i shkëputte shqiptarët nga alfabetet e vendeve fqinje, të cilat haptazi apo tinëzisht ushqenin qëllime kombëtare asimiluese ndaj tyre.

Studiues të shumtë, si: historianë, gjuhëtarë, kritikë letrarë, didaktë e politologë i janë referuar dhe e kanë analizuar nga këndvështrime të ndryshme këtë ngjarje, duke na dhënë studime komplekse, herë përmes trajtimeve të çështjeve që në mënyrë të ndërsjellë kanë pasur ndikim te njëra-tjetra, e herë duke u ndalur në mënyrë të posaçme vetëm te një prej vendimeve të marra nga Kongresi. Kjo shpjegohet me faktin se Kongresi i Manastirit ishte produkt historik kombëtar gjithëpërfshirës. Ai u përball me një problematikë komplekse politike, shoqërore, kulturore e arsimore, e cila e bëri bashkë elitën më të rëndësishme kombëtare të kohës, me synimin për t'u dhënë zgjidhje këtyre çështjeve të themelore, duke e filluar punën me njësimin e alfabetit dhe duke e zgjeruar problematikën vendimmarrëse prej njësimit të alfabetit. Njësimi i alfabetit u bë në fakt shtrati kulturor përbashkues tek i cili konvergonin të gjitha çështjet që synonin bashkimin kombëtar Veri-Jug, myslimanë dhe të krishterë me synim shkëputjen nga Perandoria Osmane dhe nga vendet përreth si dhe hedhjen e themeleve të shtetit shqiptar.

Larmia e problemeve ku ndodheshin trevat shqiptare në këtë kohë, të cilat lidheshin fort sa me një kontekst gjeopolitik përtej shqiptar, gjithaq edhe me një kontekst të brendshëm shqiptar, shpjegon qartë arsyen e interesit për një

pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha trevat e qendrat intelektuale, por mandej edhe faktin tjetër, se këta pjesëmarrës po vinin në Kongres si personalitete përfaqësuese, me kontribute lokale e më gjerë për çështje nga më të ndryshmet në veprimtaritë e tyre kulturore, gjuhësore, shoqërore, politike, patriotike, administrative, juridike etj.

Ky kongres ia arriti të bënte bashkë në tryezë problemet që shqetësonin shqiptarët në atë kohë dhe intelektualët e veprimtarët patriotë, të cilët bënë përpjekje të izoluara për zgjidhjen e çështjeve të veçanta. Nga ana tjetër, në këtë kongres u gjet edhe 'çelësi' nga duhej të fillonte zgjidhja e tyre, siç ishte më së pari përcaktimi i një alfabeti të njësuar përbashkues mes vetes dhe ndarjes, kësisoj, nga alfabetet e tjera, bashkë me vendet dashakeqe që i përdornin.

Kjo ngjarje e rëndësishme ka marrë vëmendje të madhe si në studimet e publicistikën vendëse të kohës, ashtu edhe në shtypin dhe studimet e huaja, kryesisht të vendeve përreth. Siç do ta shohim më poshtë, interesi për studime nga këndvështrime të ndryshme për këtë ngjarje të rëndësishme vijon të mbetet aktual edhe sot pas më shumë se një shekulli. Dhe kjo shpjegohet, ndër të tjera, jo vetëm me atë se çfarë ka ndodhur si ngjarje në këtë kongres, por edhe sepse ajo që ka ndodhur ka krijuar në vijimësi lidhje shkak-pasojë me ngjarje historike kombëtare të qenësishme, që do të ndodhnin më pas.

Ndër veprat me qasje studimore komplekse historike e gjuhësore të kësaj ngjarjeje vlen të veçohet *Kongresi i Manastirit, ngjarje me rëndësi kombëtare shqiptare* (Demiraj & Prifti, 1968).

Një përmbledhje me studime, materiale arkivore e dokumente, artikuj e lajme të shtypit, në katër pjesë, e gjejmë, gjithashtu, tek *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit (14-22 Nëntor 1908)*, përgatitur nga A. Buda, M. Domi si redaktorë përgjegjës si dhe me kontributet e S. Pollos, K. Priftit dhe të M. Samarës (1972). Po kështu, një botim me ndihmesë të rëndësishme për këtë ngjarje e gjejmë edhe te *Kongresi i Manastirit për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe (14-22 Nëntor 1908)*, në *Historia e popullit shqiptar II* (2002). Nga ana tjetër, një tjetër vepër e pasur me dokumente dhe ngasje shkencore është *Drejtshkrimet e shqipes* (Ismajli, 2021). Gjithashtu, vëmendjen tonë e ka tërhequr edhe vepra trilogjike për Mjedën, *Mjeda 3, Libri i parë. Alfabeti (1899-1912)*, (Quku, 2007), e cila, pavarësisht se i kushtohet Mjedës, sjell qasje me interes për këtë ngjarje të rëndësishme. Një punë me mjaft dobi në

këndvështrimin tonë është edhe një studim me vlera të shumanshme, si: *Udha e shkronjave shqipe. Historia e alfabetit* (Osmani, 2008). Ndër studimet e fundit, që kanë ngjallur interes përmendim edhe një botim mjaft të pasur me dokumente e analiza të studiuesit Xhevat Lloshi, *Gjergj Qiriazi në Kongresin e Manastirit, I, II* (Lloshi, 2019), i cili, gjithashtu, e trajton ngjarjen e Kongresit në një rrafsh shumë të gjerë. Së fundmi, mund të përmendim një trajtim me interesa të larmishëm të shkrimtarit dhe kritikut Agim Vinca, si: *Saga e shkronjave shqipe* (Vinca, 2022). Qasje të tjera për çështje të veçanta, të botuara si kumtesa konferencash apo si artikuj në revista shkencore, janë të shumta dhe një pjesë syresh do të bëhen rast pas rasti objekt referimi gjatë këtij punimi, ku nuk mund të lëmë pa përmendur edhe dy shkrime, të botuara prej nesh, si: *Drejt Kongresit të Manastirit me idenë një alfabet, një gjuhë, një komb*, në *Çështje të gjuhës shqipe 2* (Rrokaj, 2009), *Roli i Sami Frashërit për alfabetin e gjuhës shqipe*, në *Çështje të gjuhës shqipe 4* (Rrokaj, 2018) si dhe *Njësimi i alfabetit ishte gur themeli për njësimin e gjuhës dhe të kombit* në *Çështje të gjuhës shqipe 5* (në proces në këtë botim).

2. Kushtet historike kur u mbajt Kongresi i Manastirit

Gati katër muaj para se të mblidhej Kongresi, në korrik të vitit 1908, pas përmbysjes së regjimit absolutist të sulltan Abdyl Hamitit II, nën ndikimin e mesazheve të Revolucionit Francez që i dha fund Monarkisë (1789), Revolucionit Xhonturk (Jeunes Turcs) në Turqi shpalli Hyrjetin (kushtetuta) më 23.07.1908, i cili (Hyrjeti) vuri në themel të tij parimet universale të lirisë, barazisë dhe drejtësisë, të ngjashme me ato të revolucionit në Francë.

Të gjitha popullsitë nën dominimin e ish-Perandorisë Osmane, përfshi edhe trevat shqiptare, kishin ligjërisht të drejtën e ndërmarrjes së reformave për organizimin e tyre politik e kulturor, brenda një autonomie të kufizuar. Pa humbur kohë nga shpallja e Hyrjetit, në shumë qytete kryesore të trevave shqiptare, si: Shkodra, Korça, Elbasani, Durrësi, Vlora e Berati u formuan klube apo shoqëri, të cilët vunë në rend të ditës shtimin e përpjekjeve për çështjen kombëtare. Mes tyre, në Manastir, tashmë qendër kulturore me infrastrukturë hekurudhore e lidhje me Selanikun, që i përkiste Vilajetit me të njëjtin emër, u formua klubi “Bashkimi”, i cili në muajin gusht të po këtij viti mori vendimin për thirrjen e të gjitha klubeve dhe shoqërive nga të gjitha

trevat dhe mbajtjen e një kuvendi të madh për çështjen e njësimi të alfabetit dhe zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe përmes hapjes së shkollave, si dhe diskutimin edhe të çështjeve të tjera ¹.

Kapja në kohë e këtij çasti të volitshëm historik dhe veprimi i shpejtë për përpilimin e ftesës për thirrjen e kuvendit, qysh në mbledhjen e parë (27 gusht 1908) prej klubit të sapoformuar “Bashkimi”, po jepte shenjën e parë se organizatorët po synonin t'i zgjidhnin çështjet kombëtare me ‘pendë e kartë’ e jo me luftë. Kjo mendësi e artë, që po favorizohej edhe nga vetë konteksti historik i shpalljes së Kushtetutës së re xhonturke, krijonte kushte për një reformë kulturore, administrative drejt një autonomie, e cila po mbështetej atëbotë nga mjaft klube e veprimtarë të kohës, përkundër rrymës tjetër radikale që kërkonte çlirimin e Shqipërisë dhe zgjidhjen e problematikave të krijuara përmes kryengritjes së armatosur².

Sipas dokumentit kryesor të vendimit të Kongresit të Manastirit, ekzistojnë dy data për periudhën kohore të mbajtjes së tij: sipas kalendarit osman është data 1-9 nëntor 1908, kurse sipas kalendarit gregorian është data 14-22 nëntor, së cilës i referohemi sot.

Edhe në raportin e Kongresit të hartuar në anglishte prej Gjergj Qiriazit përmenden të dyja këto data. Morën pjesë 50 delegatë nga trevat shqiptare, nga të cilët 32 me të drejtë vote, me kryetar Mit'hat Frashërin, të cilët u vendosën në shtëpinë e Fehim Zavalanit, kurse Komisioni i hartimit të alfabetit, i përbërë nga 11 delegatë, me kryetar Gjergj Fishtën, u vendos në shtëpinë e Gjergj Qiriazit³. Pa mohuar kontributin e Fehim Zavalanit në drejtimin e klubit “Bashkimi”, ashtu si dhe shumë veprimtarë të tjerë, duhet theksuar se Gjergj Qiriazit, i cili konceptoi edhe ftesën e mbajtjes së këtij kuvendi, mbetet një figurë kryesore për thirrjen dhe mbarëvajtjen e punimeve të Kongresit të Manastirit, por gjithaq edhe si hartuesi i raportit përfundimtar të tij (Lloshi, Gjergj Qiriazit, I, 2019).

¹ Saga, Vinca, 2022, f. 25-26.

² Domi, 1972, Alfabeti, f. 32.

³ Asani, Maliqi, Ditari, 2020, f. 34.

3. Përzgjedhja e alfabetit latin

Alfabetet arabo-turke, greke e sllave, si dhe ndonjë alfabet latin apo edhe eksperimental, u përjashtuan qysh në fillim nga agjenda e diskutimeve në Kongres. Përfundimisht, Komisioni do të diskutonte rreth tri alfabeve latine, që u shtruan në tryezën e bisedimeve: alfabeti latin i përdorur nga Shoqëria e Stambollit, i hartuar nga Sami Frashëri në bashkëpunim edhe me anëtarë të tjerë të saj, që në Kongres përfaqësohej e mbështetej nga Mit'hat Frashëri, alfabeti latin i Shoqërisë “Bashkimi”, i hartuar nga imzot Preng Doçi, që përfaqësohej dhe mbështetej nga Gjergj Fishta dhe alfabeti po latin i Shoqërisë “Agimi”, që ishte hartuar nga vetë Mjeda.

Ky Komision i vuri vetes si detyrë të shqyrtonte tri mundësi për njësimin alfabetik: të përshtatej njëri prej alfabeve të mësipërme, të bëhej një shkrimje e të tri alfabeve ose të hartohej një alfabet i ri, thjesht latin. Siç dihet, Kongresi vendosi të mbante dy alfabe: atë të Shoqërisë së Stambollit dhe alfabetin e ri kombëtar që përdoret sot, deri në thirrjen e një kongresi tjetër, 2 vite më vonë (2-3 prill 1910), ku çështja themelore që u diskutua në fakt ishte rikonfirmimi i alfabetit latin, të miratuar në Kongresin e Manastirit, përkundër një ofensive të Turqve të Rinj për rikthimin e alfabetit arab ⁴. Ky alfabet i ri kombëtar mbështetej në alfabetin e Stambollit, duke e plotësuar me 9 dyshkronjëshat, kryesisht të alfabetit të “Bashkimit”: *dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh* si dhe me 2 shkronjat diakritike *ç* dhe *ë*.

Koha do ta vlerësonte këtë vendim të Kongresit të Manastirit si zgjidhjen e duhur në momentin e duhur. Planifikimi gjuhësor i njësimi alfabetik po shkonte njësh me politikën gjuhësore kombëtare të përzgjedhjes së alfabetit latin ndaj alfabeve të tjera ekzistuese. Po liheshin mënjandë edhe dallimi i zanoreve të gjata nga ato të shkurtra, gjithaq edhe hundoret, tipike kryesisht për gegërishten, por jo sakaq për natyrën e alfabetit latin. Kjo zgjedhje, po aq sa dhe zgjidhje, ishte një hap, i cili përcaktoi një drejtim për atë se çfarë do të ishte disa dekada më vonë vendimmarrja për standardin. Por, më së pari, njësimi i alfabetit ishte vetë mbudhja për bashkimin e kombit nën emrin ‘kombi shqiptar’ dhe një prelud për shtetin e ri njëalfabetik.

⁴ Skëndi, Zgjimi 2010, f. 347.

4. Tre arkitektët e Kongresit: Mit'hat Frashëri, Gjergj Fishta dhe Ndre Mjeda

Kongresi i Manastirit ishte rezultat i dy kompromiseve të rëndësishme. Kompromisi i parë lidhej me gjetjen e 'gjuhës' për zgjedhjen midis tri alfabeve që po paraqiteshin në Kongres prej tri personaliteteve më të mëdha të trevave shqiptare: Mjedës që kishte alfabetin e vet në Shoqërinë "Agimi", Fishtës që përfaqësonte alfabetin e Shoqërisë "Bashkimi" dhe Mit'hat Frashërit që përfaqësonte alfabetin e Frashërllinjve të Stambollit. Kompromisi i dytë ishte se vetë këto personalitete, në fakt, përfaqësonin dhe përbashkonin politikisht e kulturalisht Veriun dhe Jugun (gegët dhe toskët) e, përpos kësaj, edhe bashkësitë fetare të myslimanëve dhe të krishterëve, pra bashkimin kombëtar përmes njësimi të alfabetit dhe, në vijimësi, arsimimin e njësuar si dhe të gjitha pikat e tjera të programit të Kongresit.

Përfaqësuesit e këtyre tri shoqërive përbënin pjesën më të madhe e cilësore të intelektualëve dhe veprimtarëve në Kongres, si nga Veriu edhe nga Jugu. Ardhja e Mit'hat Frashërit në Kongres (ditën e dytë) si pinjoll i Frashërllinjve, por edhe si sekretar i Valiut të Selanikut e poliglot, u përshëndet me fjalë diturore prej Hilë Mosit të shoqërisë "Gegnija e Shkodrës", kurse Mit'hati me shumë miradije do t'ua kthente nderin, duke ngritur lart punën e palodhur të intelektualëve shkodranë⁵. Edhe ndarja e përgjegjësi në Kongres do të mbante parasysh këtë ekuilibër. Mit'hati (alias Lumo Skëndo) do të zgjidhej kryetar i Kongresit, kurse Fishta kryetar i Komisionit për hartimin e alfabetit. Përgjegjësia e secilit ishte fort e madhe. At Gjergj Fishta do të shprehej se do të jetë "turp i madh... dhe do të qeshemi nga bota e huaj... e popullin do ta shtiem në dëshpërim nëse nuk arrihet një zgjidhje". Megjithatë, këtij kompromisi do t'i shërbente veçanërisht Mjeda, i cili, me një akt të pasqorë qytetarie e atdhetarie në dobi të interesit kombëtar, u ngrit mbi interesin vetjak. Ai hoqi vetë dorë nga alfabeti i tij shkencor për t'u hapur rrugën dy alfabeve të tjera⁶. Kjo 'tërheqje' ia rriti edhe më shumë prestigjin e besimin Mjedës, por edhe të drejtën morale, përpos zotësisë profesionale që ai e kishte, për të luajtur rolin e negociatorit midis toskëve, që mbështetnin alfabetin e Stambollit dhe gegëve, që mbështetnin alfabetin e Bashkimit.

Mbështetja e gjerë që po vinte me mesazhe, si nga Jugu për alfabetin e

⁵ Osmani, Udha, f. 515.

⁶ Qoku, Mjeda 3, f. 503.

Stambollit dhe nga Veriu për alfabetin “Bashkimi”, bëri që të votoheshin e të miratoheshin të dyja alfabetet me disa ndryshime, duke i dhënë fund kësisoj kakografisë shumalfabetore, që zotëronte deri në atë kohë.

Në fakt, alfabeti i Stambollit (1879) kishte pasur një shtrirje të gjerë dhe përdorej prej shumë vitesh. Ai ishte fryt i punës së palodhur të Samiut, në krah të të cilit ishte Pashko Vasa, Hasan Tahsini, Jani Vreto etj., dhe gjithë ky kontribut përfaqësohej në Kongres nga Mit’hat Frashëri, i cili kishte ardhur në Kongres për të ‘mbrojtur’ këtë alfabet dhe u përpoq me shumë mënyra për ta bërë një gjë të tillë⁷. Nga ana tjetër, alfabeti i Shoqërisë “Bashkimi” ishte hartuar nga abati mirditor Preng Doçi, së bashku me Ndoc Nikajn, Jak Serreqin, Luigj Gurakuqin, Gaspër Beltojën etj. dhe përfaqësohej në Kongres nga Gjergj Fishta. Por në dallim prej shumë personaliteteve të përmendura më lart, Ndre Mjeda, i cili mernte pjesë në Kongres në emër të Shoqërisë “Agimi” bashkë me mësuesin e palodhur të krahinës së Prizrenit dhe autor tekstesh e fjalorësh, Mati Logorecin, kishte një përvojë të mirëfilltë gjuhësie e filologjie, si autor tekstesh shkollore, bashkëpunëtor me albanologun Gustav Majer, por mbante gjithashtu lidhje edhe me Rrethin e Neogramatikanëve, sidomos me Pedersenin, Brugmanin etj. Ai kishte qenë gjithashtu pjesëmarrës në Kongresin VIII Ndërkombëtar të Orientalistëve në Hamburg (1902) etj. Zotësia e tij profesionale në cilësinë e anëtarit të Komisionit vinte nga një qartësi befasuese për mirë lidhur me gjuhën, funksionin e saj përbashkues, përkujdesjen për mësimin e saj apo edhe nga vetë natyra e tij vizionare për unifikimin e kombit, duke dalë haptas kundër atyre që “me fjalë e shkrime futin përçarje” etj⁸. Studiuesi Qoku shprehet se “pavarësisht nga natyra e tij polemiste... kur shtrohej problemi i lirimit të atdheut, ai ishte në gjendje të bënte gjëra të mëdha..., kurse në Manastir qe shpirti i sakrificës dhe negociatori i kompromisit”⁹. Nga ana tjetër, roli i Fishtës në cilësinë e kryetarit të Komisionit për hartimin e alfabetit ishte pa dyshim i vyer. Sigurisht, ashtu si Mit’hati për alfabetin e Stambollit edhe Fishta anonte vetiu nga varianti i Shoqërisë “Bashkimi”. I nxitur më shumë ndoshta nga abati Preng Doçi, por jo më pak edhe prej egos së tij profesionale e lokale, fakti që ishte zgjedhur edhe kryetar Komisioni, e bënte Fishtën të ndihej disi më i rëndësishëm nga të tjerët në përrethësinë kuvendore.

⁷ Lloshi, Gjergj Qiriazhi..., I, f. 208.

⁸ Mjeda, Vërejtje, 2, 1982, f. 124.

⁹ Qoku, Mjeda 3, 2007, f. 385.

Por nuk është hera e parë që mes personaliteteve të këtyre përmasave të mos ekzistonin apo të nënkuptoheshin 'qesëndisjet' intelektuale të nëntëshme, të cilat tregonin rivalitetin lokal ndaj njëri-tjetrit, siç dëshmohej edhe nga korrespondenca konfidenciale e Fishtës me imzot Preng Doçin, të cilit ia thotë troç se "nuk ishte sukses i vogël... të pranohet sistemi ynë me shpartallim të plotë të sistemit të 'Agimit'" ¹⁰. Sidoqoftë, faqe botës, në deklaratën e tij në emër të Shoqërisë "Bashkimi", Fishta u shpreh se nuk kishte ardhur për të mbrojtur atë aebece, por "për të gjetur një mënyrë që të bashkohen të tërë". Kështu, kuptohet qartë se sjelljet tinëzare, zilitë e meritë mes tyre gjithsesi nuk shkonin deri aty sa të dëmtonin gjetjen e zgjidhjes për një alfabet përbashkues kombëtar, për të cilin Mjeda do të shprehej se "shqiptarët qenkan të zotët të bashkohen dhe të punojnë së bashku"¹¹.

Zotësia profesionale dhe personaliteti i pamëdyshtë i këtyre arkitektëve të Rilindjes Kombëtare shërbeu për t'u mbudhur në rrugëtimin e bashkimit kombëtar dhe të pavarësisë së vendit dhe se njësimi i alfabetit kurorëzonte gjithaq një sinergji që kishte nisur qysh herët me Formulën e Pagëzimit, te Gjon Buzuku dhe Autorët e Vjetër. Ditët e Kongresit patën uljet e ngritjet e tyre, herë me trishtim për ngecjen e punimeve, e herë me entuziazëm për mbarëvajtjen e tyre; çdonjëra e ngarkuar me një trysni që vinte nga të gjitha trevat e ku kërkoheshin të mbështetej njëri ose tjetri alfabet, por mbi të gjitha të arrihej në gjetjen e një zgjidhjeje alfabetore njësuere përbashkuese kombëtare. Pjesë e kësaj përpjekjeje ishte edhe takimi kokë më kokë i një dite më parë i Mjedës me Mit'hatin (20 nëntor), të cilit ai ia shprehu idenë e vet dhe të nesërmen Mjeda shkroi në dërrasën e zezë të dyja variantet, që u mirëpritën prej të gjithë delegatëve, kurse Fishta propozoi të pranoheshin që të dyja variantet. Dy ditët e tjera iu kushtuan hartimit të programit me 17 pika, i cili do t'i paraqitej parlamentit turk prej deputetit Shahin Kolonja, sakaq Gjergj Qiriazi po përgatiste raportin edhe në versionin anglisht.

Për një alfabet të këtij lloji, vetë Luigj Gurakuqi, delegat i Shoqërisë "Bashkimi" dhe anëtar i Komisionit prej 11 vetësh, ishte shprehur qysh më parë se alfabeti duhet të ishte një 'abe e unjishme' (Gurakuqi, Letër De Radës, 20 nëntor 1889). Një vepër e tillë kombëtare po realizonte ëndrrën rilindëse: një alfabet, një gjuhë, një komb¹². Disa vite më vonë, me mbështetjen e

¹⁰ Osmani, Udha, f. 543-544.

¹¹ Osmani, Udha, f. 529.

¹² Rrokaj, Çështje 2, 2009.

austriakëve, idesë së konvergjencës grafike të dy dialekteve kryesore, si mjet për bashkimin kombëtar do t'i shërbente Komisia Letrare e Shkodrës (1916-1918) me vendimet që mori për t'i hapur rrugën një politike gjuhësore të re për realizimin e standardit të shqipes dhe ku luajtën rol të madh personalitete të Kongresit, si: Fishta, Mjeda, Gurakuqi, Logoreci, Mosi, Peci, përpos edhe shumë të tjerëve, si: Xhuvani, Pekmezi, Prenushi, Nivica bashkë me albanologët Lamberc e Nahtigal¹³.

Të tre këta arkitektë punëbukur të Kongresit të Manastirit, mjeshtër të fjalës shqipe e ideatorë të bashkimit kombëtar, fill pas Kongresit, iu vunë punës për realizimin e vendimeve të tij. Mjeda boton vjershën *Andërr*, kurse Fishta boton vjershën *Tingllim*. Mit'hat Frashëri i botoi këto vjersha në revistën *Diturija* të Sofjes si dhe te gazeta *Liria* e Selanikut. Përpos kësaj, Mit'hati do të botonte në revistën *Diturija* (mars 1909) edhe dy fotografi me të dhënat përkatëse për secilin nga personalitetet pjesëmarrëse në Kongres, njëra me 32 delegatët anëtarë, kurse tjetra me 11 anëtarët e Komisionit të hartimit të alfabetit, duke sqaruar edhe ndonjë mungesë në secilën prej tyre. Për këtë vepër madhore shqiptare, atdhetari Dervish Hima do të jepte këtë mesazh, i cili vlen për të gjitha kohët, se 'shkronjat kombëtare' janë shprehje e unitetit të kombit dhe se nuk do të përmendet aspak fjala 'gegë, toskë, labër e të tjera, por vetëm shqiptar'¹⁴.

5. Përfundime

1. Kongresi i Manastirit i dha fund kaosit të një epoke me shumë alfabete, duke hedhur themelet e një epoke moderne të shkrimit shqip me një alfabet të vetëm latin, gjë që do ta lehtësonte në vijim komunikimin mes shqiptarëve. Me këtë akt ai shënoi, gjithashtu, hapin e parë drejt një politike gjuhësore alfabetore unifikuese. Kjo zgjidhje ndikoi dukshëm në unifikimin e arsimit shqip, si dhe në zhvillimin e gjinive të shkrimit, sidomos të letërsisë artistike, përtej hapësirës ku atëbotë e mbanin trajtat dialektore të shkrimit.

2. Përveçse ishte një Kongres alfabetik, dhe kjo është çështja kryesore me të cilën identifikohet kjo ngjarje madhore kombëtare, Kongresi i Manastirit

¹³ Rrokaj, Çështje 4, f. 89.

¹⁴ Prifti, Dervish Hima, 1987, f. 201.

hodhi themelet e pajtimit përmes një kompromisi përbashkues kombëtar, duke mënjeluar rrezikun real të përçarjes, që vinte nga politika xhonturke, e cila nuk po zbatonte më parimet liberale të Hyrjetit për vetëvendosjen e popullsisë në territoret perandorake lidhur me të drejtat e tyre, ndër to edhe ato gjuhësore. Nga ana tjetër, qarqet fqinje sllavo-greke, që kishin synime territoriale ndaj trevave shqiptare, po kuptonin dita-ditës se si ato po dështonin në projektet e tyre aneksuese. Ky pajtim për njësimin e alfabetit po sheshonte gjithashtu xhelozitë e kundërshtitë krahinore Veri-Jug, por gjithaq edhe fanatizmin fetar të kundërvënies myslimanë e të krishterë; gjithë kjo në emër të një bashkimi vëllezërisht të një gjaku me emrin shqiptar.

3. Ky pajtim përmes kompromisit për njësimin e alfabetit i hapi gjithashtu rrugë lëvizjes për çlirim kombëtar dhe emancipim shoqëror. Intelektualë dhe patriotë, që morën pjesë në Kongres nga të gjitha trevat, treguan dituri e vendosmëri, sepse kuptuan se njësimi i alfabetit ishte rruga e duhur për të mbërritur te bashkimi kombëtar, përkundër rrugës tjetër radikale të përplasjes dhe konfrontimit si mënyrë për të mbërritur te njësimi i alfabetit, siç shpërfaqej gjendja në atë kohë në mjaft rrethe e klube radikale¹⁵. Në fakt, kjo rrugë e mençur e bashkimit përmes alfabetit të njësuar, e ndihmuar edhe nga rrethanat politike të krijuara, fill pas shpalljes së Hyrjetit të Turqve të Rinj, i dha këtij Kongresi, për herë të parë në historinë e shqiptarëve, dimensione jo thjesht e vetëm të një ngjarjeje kulturore dhe gjuhësore, por edhe të një manifesti politik e patriotik, që synonte jo vetëm shkëputjen prej Turqisë, por edhe hedhjen e themeleve institucionale të shtetit të ri shqiptar, i cili do të shpallej 4 vite më vonë në Vlorë më 28 nëntor 1912.

4. Përcaktimi i alfabetit latin si bazë grafike, për të cilin konkurronin fillimisht të tria alfabetet, mandej vetëm dy prej tyre pas tërheqjes së Mjedës, jo vetëm rikthente traditën e shkrimit shqip prej Formulës së Pagëzimit, te Buzuku e këtej, por shënonte një kthesë me orientim të qartë evropian për shqiptarët. Shkëputja prej alfabeve ekzistuese arabo-turke, greke apo sllave shënonte gjithashtu një ndarje me vendet përreth, të cilat kishin pretendime territoriale aneksuese ndaj Shqipërisë, po aq sa edhe prej vetë pushtuesve osmanë.

5. Siç u theksua më lart, Kongresi nuk ishte thjesht një ngjarje kulturore kombëtare me karakter unifikues thjesht gjuhësor. Po aty u hartua edhe një program me kërkesa politike, administrative, kulturore e arsimore me 17

¹⁵ Lloshi, Gjergj Qiriazi..., II, f. 425.

pika për bashkimin kombëtar dhe për shkëputjen nga Perandoria Osmane, ku ngriheshin çështje të njohjes zyrtare të gjuhës shqipe dhe të kombësisë, arsimimin masiv në shkolla fillore shqipe, rregullimin administrativ të funksionarëve të administratës etj.

Por, pa dyshim, pa zgjidhjen fillimisht të njësimit të alfabetit do të kishte qenë thuajse e pamundur në këto kushte arritja e këtij programi për bashkimin politik, i cili u hartua në dy ditët e fundit, pasi tashmë ishte zgjidhur çështja njësimit të alfabetit.

Bibliografi

Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit (14-22 Nëntor 1908), Studime, materiale, dokumente, Tiranë, 1972.

Asani, Skënder. Maliqi-Zylali, Nora. *Ditari i Parashqevi Qiriazi*, Shkup, 2020.

Demiraj, Shaban. Prifti, Kristaq. *Kongresi i Manastirit - ngjarje me rëndësi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Tiranë 1968.

Kongresi i Manastirit për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe (14-22 nëntor 1908) në Historia e popullit shqiptar II, Toena, Tiranë, 2002.

Ismajli, Rexhep. *Drejtshkrimet e shqipes*, Botimpex, 2021.

Letër e Luigj Gurakuqit dërguar De Radës nga Shën Mitër Korona, më 20 nëntor 1899.

Luarasi, Skënder. *Kongresi i dytë i Manastirit*, në librin *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë, 1972.

Lloshi, Xhevat. *Rreth alfabetit të shqipes*, me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit, Logos-A, Shkup, 2008.

Lloshi, Xhevat. *Gjergj Qiriazi në Kongresin e Manastirit, I, II*, Shkup, 2019.

Osmani, Tomor. *Udha e shkronjave shqipe. Historia e alfabetit*, Tiranë, 2008.

Quku, Mentor. *Mjeda 3, Libri i parë Alfabeti (1899 – 1912)*, Ilar, Tiranë, 2007.

Prifti, Kristaq. *Dervish Hima*, Tiranë, 1987.

Rrokaj, Shezai. *Drejt Kongresit të Manastirit me idenë një alfabet një gjuhë një komb*, në *Çështje të gjuhës shqipe 2*, Shkronjë pas shkronje, Tiranë, 2009.

Rrokaj, Shezai. *Sami Frashëri për alfabetin e gjuhës shqipe*, në *Çështje të gjuhës shqipe 4*, Pegi, Tiranë, 2018.

Skëndi, Stavro. *Zgjimi kombëtar shqiptar*, Phoenix, Tiranë, 2000.

Vinca, Agim. *Saga e shkronjave shqipe*, Shkup, 2022.